



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2024:230520  
Datë: 12.11.2024  
Numri i dokumentit: 06442192

K.Dh.Sh.II.nr.2024/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS– Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar i kolegjit, Faton Bajrami dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, në konfliktin administrativ të paditësit Kompania Rajonale Ujësjiellësi “Prishtina” Sh.A., me seli në rrugën Hazir Shala p.nr. në Prishtinë, kundër të paditurit Agjencia për Informim dhe Privatësi, me seli në rrugën Zejnel Salihu nr. 22-10000, Prishtinë, me propozim për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti Administrativ KA.nr.464/2024 të datës 24.09.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 12.11.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditëses Kompania Rajonale Ujësjiellësi “Prishtina” Sh.A., me seli në rrugën Hazir Shala p.nr. në Prishtinë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti Administrativ KA.nr.464/2024 të datës 24.09.2024 VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Me aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti Administrativ KA.nr.464/2024 të datës 24.09.2024, është refuzuar në tërësi si e pabazuar kërkesa e paditësit Kompania Rajonale Ujësjiellësi “Prishtina” Sh.A., me seli në Prishtinë për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ me numër të protokollit 884 të datës 20.08.2024, të paditurit Agjencia Për Informim dhe Privatësi me seli në Prishtinë, derisa gjykata të vendos me vendim përfundimtar gjyqësor lidhur me padinë e paditësit.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka parashtruar ankesë paditësja KRU Prishtina, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale. Me ankesë e paditura ka propozuar që gjykata e shkallës së dytë ta miratojë propozimin e paditëses ashtu që refuzojë në tërësi Aktvendimin KA.nr464/24 të dt.24.09.2024

Kolegji i Dhomave të Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, pas shqyrtimit të ankesës, shkresave të lëndës dhe pretendimeve ankimore, vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të ankimuar në kuptim të nenit 13 par. 6 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe Nenit 194 të LPK-së, dhe gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Paditësi përmes padisë së datës 22.08.2024, të dorëzuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative ka iniciuar konfliktin administrativ me kërkesë për anulimin e aktit administrativ me numër të protokollit 884 të datës 20.08.2024, të paditurit Agjencia Për Informim dhe Privatësi me seli në Prishtinë (këtu e tutje Akti). Me padi ka paraqitur edhe kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të sapo cekur, deri në vendosjen definitive të gjykatës lidhur me padinë e tij (këtu e tutje Kërkesa), ndërsa Gjykata Themelore në Prishtinë përmes aktvendimit A.nr.3519/2024 të datës 23.08.2024, është shpallur jo kompetente në kuptimin lëndor dhe e ka vlerësuar Gjykatën Komerciale kompetente për të vendosur në këtë çështje. Paditësi, në kërkesën e tij për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, e cila është pjesë përbërëse e padisë, e ka trajtuar ligjshmërinë e aktit administrativ të goditur, ndërsa nuk e ka ngritur asnjë pretendim lidhur me kushtet e nenit 22 para. 2 dhe 6 të LKA-së, por thjeshtë ka kërkuar të ndalohet ekzekutimi i aktit të goditur.

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti Administrativ i Gjykatës Komerciale me aktvendimin e atakuar KA.nr.464/2024 të datës 24.09.2024, e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesën e paditësit Kompania Rajonale Ujësjiellësi “Prishtina” Sh.A., me seli në Prishtinë për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ me numër të protokollit 884 të datës 20.08.2024, të paditurit Agjencia Për Informim dhe Privatësi me seli në Prishtinë, derisa gjykata të vendos me vendim përfundimtar gjyqësor lidhur me padinë e paditësit.

Gjykata e Shkallës së parë në arsyet e aktvendimit të ankimuar ka theksuar se Pas shqyrtimit të pretendimeve të Paditësit, si parashtrues i kërkesës për shtyrjen e vendimit, dhe provave të bashkëngjitura me padinë e tij, gjykata vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet nga neni 22 para. 2 lidhur me para. 6 të LKA-së për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit. Paditësi nuk e ka provuar se me ekzekutimin e Vendimit atij do t'i shkaktohej dëm, i cili vështirë do të riparohet, si kusht i parë për shtyrje të ekzekutimit të vendimit. Në fakt, siç është sqaruar më lartë, Paditësi në tërë kërkesën e tij për shtyrjen e ekzekutimit nuk pretendon se ekzekutimi i aktit administrativ lëndor do t'i shkaktonte atij ndonjë dëm, i cili vështirë riparohet, ndërsa as nga provat që gjenden në shkresat e lëndës nuk rrjedhë ndonjë formë e dëmit, i cili është vështirë të riparueshëm. Për këtë arsye, gjykata konstaton se kushti i parë ligjor për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ nuk është përmbushur. Ngjashëm, lidhur me pajtueshmërinë e shtyrjes së ekzekutimit të aktit administrativ me interesin publik (kushti i dytë), Paditësi nuk e ka ngritur asnjë pretendim se shtyrja e ekzekutimit të vendimit administrativ të goditur nuk do të ishte në kundërshtim me interesin publik, e aq më pak kanë paraqitur prova për ta provuar plotësimin e kushtit të dytë nga neni 22 para. 2 të LKA-së. Në lidhje me kushtin e tretë për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, gjykata vlerëson se edhe nëse nga shtyrja e ekzekutimit të aktit administrativ nuk do t'i shkaktohej dëm të Paditurit, megjithatë kjo nuk është më relevante, përderisa kushtet tjera nuk janë plotësuar.

Kolegji i Dhomave të Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë. Sipas vlerësimit të Kolegjit, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur e ka refuzuar propozimin e paditëses për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, për faktin se shtyrja e ekzekutimit nuk i shkakton ndonjë dëm të riparueshëm të paditurës. Përkundrazi, kjo Gjykatë vlerëson se lënia në fuqi e vendimit që është objekt i konfliktit administrativ do të nënkuptonte zgjidhjen meritorë të çështjes, duke paragjykuar vendimin përfundimtar. Në këtë drejtim, kolegji

vlerëson se paditësja nuk ka marr mundin të parashtrijë asnjë provë për të mbështetur pretendimet e veta se ky vendim i shkakton paditëses dëm të pariparueshëm.

Mbi bazën e pretendimeve ankimore, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se fakti se paditësja nuk ka parashtruar asnjë provë, propozimet ankimore janë të pathemelta dhe nuk gjejnë mbështetje për shtyrje të ekzekutimit të vendimit kontestues. Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë, nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin nuk konkret janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ sa i përket pikave 1, 2 dhe 4 të vendimit kontestues, siç është paraparë në nenin 22 par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Duke i marrë parasysh pretendimet ankimore të paditurës, në ankesë, të cekura më lartë ndaj aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, Kolegji vlerëson se të njëjtat janë të pabazuara dhe të pamjaftueshme për tu aprovuar ankesa dhe për tu hedhur poshtë aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë, siç propozon e paditura me ankesë. Pretendimet e tjera, Dhoma e Shkallës së Dytë i vlerësoi si të pabaza pasi që krahas përshkrimit të fakteve të çështjes nuk kanë në përmbajtje ndonjë arsye ligjore dhe bindëse për tu vendosur ndryshe.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Kolegji gjen se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe me rastin e vendosjes nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën (b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
Dhomat e shkallës së dytë  
Kom.Dh.shk.II.nr.2024/2024, me datë 12.11.2024

Kryetari i Kolegjit  
Dren Rogova